

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si autoriteti përgjegjës që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke vlerësuar zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

Duke synuar forcimin e mekanizmave institucionalë të barazisë në shoqëri dhe rolin e tyre për funksionimin e një shoqërie demokratike, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, pa diskriminim dhe intolerancë;

Duke mbështetur e nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel qendror e vendor, me shoqërinë civile, median dhe publikun,

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2024 në këto drejtime:

Angazhimin e qëndrueshëm dhe efektiv në trajtimin e një numri të konsiderueshëm çështjesh, përfshirë edhe ankesat e qytetarëve.

Rritjen e ankesave të depozituara nga grupe personash, çka tregon rritjen e ndërgjegjësimit publik për rolin dhe mekanizmat e mbrojtjes nga diskriminimi, megjithëse numri i ankesave të paraqitura nga organizatat me interesa legjitime ka shënuar një rënie në krahasim me vitin 2023.

Komisioneri ka vijuar të ushtrojë funksionet e tij me efikasitet përmes dhënies së një numri të konsiderueshëm vendimesh dhe rekomandimesh, duke kontribuar në forcimin e zbatimit të ligjit dhe në përmirësimin e standardeve të mbrojtjes nga diskriminimi.

Në drejtim të përfaqësimit gjyqësor, institucioni ka ndjekur me përgjegjësi një numër të madh procesesh në juridiksionin civil dhe administrativ, si dhe ka marrë pjesë rregullisht në seanca gjyqësore pranë gjykatave përkatëse. Kuvendi e vlerëson këtë rritje të dukshme të përfshirjes si një tregues të rritjes së rolit aktiv të Komisionerit në mbrojtjen ligjore të të drejtave të individëve.

Nismat ndërgjegjësuere të zhvilluara në institucionet arsimore të ulëta dhe të mesme, të cilat synojnë adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes.

Bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Komisionerit, zyrave rajonale dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, në kuadër të përpjekjeve për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe të dhunës në hapësirat mediatike dhe *online*, si dhe rolin aktiv të institucionit në nxitjen e një debati publik të shëndetshëm dhe gjithëpërfshirës.

Veprimtarinë ndërgjegjësuere dhe komunikimin publik të zhvilluar nga Komisioneri, përmes daljesh në media dhe organizimit të aktiviteteve informuese e edukative, të cilat kanë kontribuar në përhapjen e vlerave të barazisë, respektit dhe mosdiskriminimit në shoqëri.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2025:

1. Të angazhohet në propozimin e ndryshimeve ligjore “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me qëllim fuqizimin e rolit të Komisionerit për të lëshuar urdhra ekzekutivë në vend të rekomandimeve.

2. Të kryejë një vlerësim të mirëfilltë të situatës, duke monitoruar procesin e përdorimit teknologjik për shërbimet publike bazë arsimore, sociale, etj., për të vlerësuar nëse ka rezultuar diskriminues tek shtresat në nevojë dhe ato në kushte vështirësie ekonomike, e ta përcjellë atë pranë Kuvendit të Shqipërisë brenda muajit dhjetor të vitit 2025.

3. Të rrisë numrin e trajtimit të çështjeve të nisura me iniciativën e vetë Komisionerit.

4. Të angazhohet në përmirësimin e realizimit të treguesve financiarë buxhetorë, sidomos për atë të investimeve.

5. Të angazhohet në realizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere lidhur me fenomenin e gjuhës së urrejtjes, në shkollë, institucione, si dhe për publikun e gjerë.

6. Të rrisë angazhimin në menaxhimin e kapaciteteve aktuale, në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta.

7. Të angazhohet intensivisht në kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin, sipas përcaktimeve të nenit 32, shkronja “e”, të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Miraturar në datën 16.10.2025.

KRYETAR
Niko Peleshi